

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6306
E mërkurë, 5 maj 2021
çmimi 0.40 €

FSK-ja, pjesëmarrëse në mesin e 27 shteteve në ushtrimin ushtarak "Defender Europe 21"

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", HAXHI SHALA | FAQE 4-5

DONIKA GËRVALLA DUHET TË PËRBALLET ME NDËRGJEGJEN E SAJ



Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, zyrtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka thënë se nëse ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka dorëzuar dosje kundër UÇK-së në Hagë, ka etiketuar emrin

e saj dhe ka njoftuar veprën heroike të babait të saj. Në një bisedë për "Epokën e re", ai ka vlerësuar se Gërvalla duhet të përballet me ndërgjegjen e saj ngaqë UÇK-ja ka ndjekur rrugën e prindit të saj, Jusuf Gërvalla. Sipas Shalës, presidentja

dhe kryeministri duhet të deklarohen nëse garantojnë mbrojtjen në liri të krerëve të UÇK-së të cilët gjenden në Hagë. Shala ka theksuar se Kosova tani po përballet me një pushtet arrogant dhe shpërfillës

OPINION

KUSH MUND TË FITOJË MBI EDI RAMËN? F. 10

Shkruan:
Bedri ISLAMI



AKTUALE

BASHA I QUAN ZGJEDHJET "MASAKËR ELEKTORALE" F. 2

KOSOVA PRITET TË PRANOJË MBI 4 000 DOZA TË 'PFIZER'-IT F. 3



EKONOMI



PAVARËSISHT PREJ PANDEMISË, NË KOSOVË RRIETET KËRKESA PËR KREDI PËR BLERJEN E SHTËPIVE F. 9

SEKRETARIATI I KOMUNITETIT I ENERJISË VAZHDON PËRKRAHJEN PËR SEKTORIN E ENERJISË F. 9

SPORT

SOT DERBI GJILANI - DRITA F. 12

LAJÇAKU: JAM KUNDËR NDRYSHIMIT TË KUFIJVE, ËSHTË IDE E RREZIKSHME QË PROVOKON LUFTË

FAQE 3



MUSTAFA: ÇËSHTJA E 'TREPÇËS' ASSESI NUK DO TË DISKUTOHET NË BRUKSEL

FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Basha i quan zgjedhjet 'masakër elektorale'

TIRANË, 4 MAJ - Kryetari i partisë opozitare, Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka kontestuar të martën rezultatit të zgjedhjeve të 25 prillit, duke e quajtur "masakër elektorale" procesin zgjedhor që i dha Partisë Socialiste mandatin e tretë qeverisës në Shqipëri. Lulzim Basha e bëri këtë deklaratë një javë pas zgjedhjeve, prej të cilave partia e tij ka shënuar rritje, duke marrë 59 vende në kuvendin e ri, krahasuar me 46 që ka pasur më 2017. "25 prilli

është një masakër elektorale, viktima e së cilës nuk është Partia Demokratike dhe deputetët tanë. Rezultati ynë flet qartë. Besimi, shpresa që zgjuam dhe bashkuam pavarësisht prej rolit të paprecedent të krimit të organizuar dhe parave të pista të krimit dhe, siç tha edhe raporti paraprak i OSBE-ODHIR, shkrirjes së vijave ndarëse mes partitë dhe shtetit, nuk ia doli dot të zvogëlonte apo t'i ulte përmasat e një

bashkimi të shqiptarëve", u shpreh Basha.

Në zgjedhjet e 25 prillit Partia Socialiste fitoi 74 mandate, Partia Demokratike ka marrë 59 mandate, ndërsa Lëvizja Socialiste ka pësuar humbje, ku ka arritur që të marrë vetëm katër mandate nga 19 që ka pasur në zgjedhjet e kaluara, të mbajtura më 2017. E fundit me numër të përfaqësuesve në kuvend është Partia Social-Demokrate, e cila ka fituar tre mandate.



Bideni rrit kuotën e pranimit të refugjatëve në ShBA



WASHINGTON, 4 MAJ - Presidenti amerikan Joe Biden ka rritur zyrtarisht kuotën e pranimit të refugjatëve në Shtetet e Bashkuara në 62 500 për këtë vit, duke cituar "një situatë të paparashikuar dhe urgjente të refugjatëve në botë".

Ky vendim ka ardhur disa javë pasi Bideni është përballur me kritika për vonim të vendimit për ta zëvendësuar kuotën tejet të vogël të pranimit të refugjatëve, të prezantuar nga paraardhësi i Bidenit, Donald Trump.

Përmes një deklaratë, Bideni ka thënë se veprimet e tij "zhdukin shifrën historikisht të ulët prej 15 000 refugjatësh, të

vendosur nga administrata e kaluar, e cila nuk ka reflektuar vlerat amerikane si komb që mirëpret dhe mbështet refugjatët".

Shifrat e reja të pranimit të refugjatëve "dërgojnë mesazh të rëndësishëm se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të jenë strehë e sigurt për disa prej njerëzve më të pambrojtur në botë", ka thënë Bideni përmes një deklaratë.

Mirëpo presidenti amerikan e ka pranuar se ShBA-ja nuk do të mund të pranojë 62 500 refugjatë deri në fund të vitit fiskal, që përfundon në fund të muajit shtator, për shkak të pandemisë së koronavirusit

dhe kufizimeve të tjera.

Për dallim nga sistemi i azilit për migrantët që arrijnë në kufirin amerikan, programi për refugjatët ekziston për njerëzit nga e gjitha bota, përfshirë disa që ikin nga konfliktet.

Aplikacionet e tyre analizohen mirë, para se të hyjnë në Shtetet e Bashkuara.

Në kuotën e re përfshihen 4 000 refugjatë nga Evropa dhe Azia Qendrore, 22 000 nga Afrika, 6 000 nga Azia Lindore, 5 000 nga Amerika Latine dhe Karaibet dhe 13 000 nga Azia Jugore.

Në këtë kuotë do të ketë hapësirë për 12 500 aplikacione, pa përcaktim të territorit.

23 persona vdesin në një aksident metroje në Meksiko Siti

MEKSIKO SITI, 4 MAJ - Të paktën 23 persona kanë vdekur dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur në Meksiko Siti si pasojë e shembjes së një linje të metrosë, derisa treni po kalonte aty, kanë thënë autoritetet meksikane më 4 maj.

Pamjet e kamerave të sigurisë, të transmetuara në mediat lokale, kanë shfaqur trenin duke rënë nga një lartësi prej pesë metrash. "Fatkeqësisht ka fëmijë në mesin e të vdekurve", ka thënë kryetarja e Meksiko Sinit,

Claudia Sheinbaum, para gazetarëve, duke thënë se 70 persona janë të plagosur.

Ky incident ka ndodhur në linjën 12 të metrosë, ndërtimi i së cilës është përcjellë me ankesa dhe akuza për parregullsi.



EMA nis rishikimin e vaksinës kineze kundër koronavirusit



BRUKSEL, 4 MAJ - Agjencia Evropiane e Ilaçeve ka nisur procedurën e rishikimit të vaksinës kundër koronavirusit, të kompanisë kineze "Sinovac". Të dhënat është thënë se do të analizohen me procedurë të përspejtuar. Ekspertët e kësaj agjencie kanë arsyetuar vendimin për

rishikim të këtij lloji, me rezultatet preliminare nga studimet klinike dhe ato laboratorike.

Ata kanë thënë se është e qartë se vakcina stimulon prodhimin e antitropave kundër koronavirusit dhe mund të jetë efektive si masë mbrojtëse kundër Covid-19,

sëmundjes që shkakton koronavirusi.

Agjencia Evropiane e Ilaçeve deri më tani ka miratuar katër vakcina në Bashkimin Evropian: 'Pfizer/BioNTech', 'Moderna', 'AstraZeneca' dhe 'Johnson & Johnson'.

Tri vakcina të tjera është thënë se janë të fazë të rishikimit.

Kosova pritet të pranojë mbi 4 000 doza të 'Pfizer'-it

PRISHTINË, 4 MAJ - Kosova pritet të pranojë të martën 4 680 doza të vaksinës 'Pfizer/BioNTech', konfirmuan për "Radion Evropa e Lirë" zyrtarë për media të Ministrisë së Shëndetësisë. "Kjo është pjesë nga kontingjenca prej 95 000 dozave që Bashkimi Evropian i ka ndarë për Kosovën në kuadër të ndihmës në vaksinim kundër Covid-19 për shtetet e Ballkanit Perëndimor", thonë nga Ministria e Shëndetësisë. Në prill, Bashkimi Evropian njoftoi se do të shpërndajë 651 000 doza të vaksinave kundër koronavirusit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga kjo sasi, Kosova do të përfitojë 95 000 doza, të cilat, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, do të vijjnë "javë pas jave". Me kontingjentin e vaksinave që

arrin të martën në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë thotë se do të vaksinohet personeli shëndetësor që nuk është vaksinuar gjatë fazës së parë të fushatës së imunizimit, më pas personat e moshuar dhe ata me sëmundje kronike.

Kosova nisi fushatën e vaksinimit kundër Covid-19 më 29 mars, me 24 000 dozat e vaksinës së 'AstraZenecas', që i mori falas nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Nga COVAX-i, Kosova në total pritet të marrë 100 800 doza.

Qeveria e Kosovës ka thënë se deri në fund të vitit planifikohet që të vaksinohen deri në 70 për qind e popullatës.

Plani shtetëror i imunizimit është i ndarë në tri faza.

Në fazën e parë janë përfshirë



punëtorët shëndetësorë, personat mbi 80 vjeç, banorët e shtëpive të kujdesit dhe ata me sëmundje kronike.

Në fazën e dytë bëjnë pjesë personat 65-79 vjeç, mësimdhënësit dhe forcat e sigurisë që janë të përfshirë në

menaxhimin e pandemisë. Ndërkaq, në fazën e tretë pritet të bëhet vaksinimi i 50 për qind të popullatës.

Lajçaku: Jam kundër ndryshimit të kufijve, është ide e rrezikshme që provokon luftë



PRISHTINË, 4 MAJ - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajcak, ka folur për "non-paper"-in e parë të publikuar në të cilin përshkruheshin ndryshime të kufijve në disa shtete të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën dhe Bosnje e Hercegovinën. Lajcak ka thënë se ideja e

rivizatimit të kufijve nuk është diçka e re dhe se ka qenë e pranishme për vite të tëra. Megjithatë, ai thotë se është kategorikisht kundër ndryshimit të kufijve, derisa shton se "non-paper" që parashikon ndryshime të kufijve është e rrezikshme dhe ide që provokon luftë. "S'dua t'i komentoj këto letra. Ideja e rivizatimit të kufijve nuk është ide e re, ka

qenë këtu për vite. Unë plotësisht jam kundër një ideje të tillë. Është tërësisht e rrezikshme dhe ide që provokon luftë", ka thënë Lajcak.

Këto deklarata Lajcak i ka bërë në një bashkëbisedim të organizuar nga "Italian Institute for International and Political Studie" me temën "The Geopolitical Gambles in the Balkans".

Përlaskaj: Kroacia nuk ka ofruar garanci për mbrojtjen në liri të Thaçit

Prishtinë, 4 maj - Deputetja shqiptare në Kuvendin e Kroacisë, Ermina Lekaj-Përlaskaj, ka demantuar lajmin, duke thënë se asnjëherë nuk ka thënë se autoritetet kroate po punojnë për të ofruar garanci në Gjykatën Speciale për mbrojtjen në liri të ish-presidentit Hashim Thaçi dhe të tjerëve që po mbahen në paraburgim në Hagë. "Nuk kam asnjë informacion zyrtar ose konfirmim se Kroacia mund të ofrojë garanci për lirim të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Unë s'kam thënë kurrë se autoritetet kroate po punojnë në këtë drejtim, por se s'ka asnjë informacion zyrtar për këtë. Mediat serbe qëllimisht apo pa qëllim më kanë keqinterpretuar", ka thënë

deputetja shqiptare e Kuvendit të Kroacisë, Ermina Lekaj Përlaskaj, për gazetën kroate "Jutarnji List".

Një nga ish-komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysen Berisha, në një deklaratë në njërin nga televizionet e Kosovës javën që shkoi, tha se presidenti kroat Zoran Milanović ka ofruar që të jetë garantues te Gjykata Speciale për lirim të ish-presidentit Thaçi dhe të tjerëve që të mbrohen në liri. "Me të vërtetë nuk e di se nga e ka marrë Berisha këtë informacion. Hashim Thaçi nuk është shtetas i Kroacisë dhe si juriste, nuk e kam të njohur modelin ligjor në bazë të të cilit Kroacia do të mund të ishte garantuese për një person që s'është shtetas i saj", ka thënë Përlaskaj.





FLET PËR "EPOKËN E RE", HAXHI SHALA

Donika Gërvalla duhet të përballet me ndërgjegjen e saj

Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, zyrtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka thënë se nëse ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka dorëzuar dosje kundër UÇK-së në Hagë, ka etiketuar emrin e saj dhe ka njollosur veprën heroike të babait të saj. Në një bisedë për "Epokën e re", ai ka vlerësuar se Gërvalla duhet të përballet me ndërgjegjen e saj ngaqë UÇK-ja ka ndjekur rrugën e prindit të saj, Jusuf Gërvalla. Sipas Shalës, presidentja dhe kryeministri duhet të deklarohen nëse garantojnë mbrojtjen në liri të krerëve të UÇK-së të cilët gjenden në Hagë. Shala ka theksuar se Kosova tani po përballet me një pushtet arrogant dhe shpërfillës

mos dashur të mbrojë veten, sepse mua më mbron ndërgjegjja ime, veprimtaria ime, përcaktimi im në vitet '90 në anën e rrugës së sakrificës, pra rreshtimi im në radhët e UÇK-së, kur Kosova si vend, si populli, si tërësi dhe shqiptari si individ ishte i robëruar nga Serbia. Por kurrë nuk mund të heshtë sot në vitin 2021 në dekadën e tretë të lirisë së Kosovës përballë arrogancës, urrejtjes dhe shpërfilljes së përfituesve të pushtetarëve të lirisë sonë", ka theksuar Shala.

Sipas ish-deputetit Shala, sot Kosova po dëmtohet nga pushteti i ri. "Sot si asnjëherë për fatkeqësinë e historisë tonë të lavdishme, krerët e gjallë, themeluesit e UÇK-së, gjenden në Hagë dhe përballet me akuzat e fabrikuar nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj nuk i lëndon as ata dhe as mua si Haxhi Shala. Dëmi i madh, lëndimi moral e shtetëror, sot po na vjen si komb nga përfituesit, pra pushtetarët e lirisë së Kosovës, me shpërfilljen e tyre ndaj përballet me historinë sonë të lavdishme në Hagë", ka deklaruar ai.

Më tej, Shala ka bërë me dije se ish-udhëheqësit e UÇK-së që janë në Hagë askush nuk mund t'i dënojë prej kërrigave të

pushtetit në Kosovë. "Unë e di dhe të gjithë e kuptojmë së ekonomia, papunësia, korrupsioni, drejtësia, arsimit, shëndetësia janë sfida të vërteta që populli votoi, dhe përfituesit e pushtetit të lirisë e morën besimin. Në rregull le t'i zgjidhin këto probleme dhe fajtorët le t'i adresojnë. Por që luftën e UÇK-së, procesin e Hagës dhe krerët e saj, askush nuk mund t'i shpallë fajtorë nga kërriga e presidentit, kryeparlamentarit, kryeministrit dhe ministres së Jashtme, kushdo qofshin aty dhe as këta sot", është shprehur Shala. Sipas tij, fituesit e zgjedhjeve të 14 shkurtit e kanë humbur mendjen në karriget e pushtetit. "Përfituesit e lirisë, votuesi që i ka votuar me votën e lirë, që ne e respektojmë, është duke i soditur që kanë humbur toruan, mendjen dhe shpirtin në muajin e mjaltit të qejfit të karrigeve të pushtetit. Përfituesit e pushtetit të lirisë duhet ta dinë se shteti ndërtohet me vendime dhe veprime, jo me përralla e pallavra nëpër konferenca e fjalime të bukura. Populli po ua shënon e liston gabimet, urrejtjen, arrogancën e injorancën. Për këto qasje unë nuk ju uroj suksese!", ka thënë Haxhi Shala, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës dhe zyrtar i AAK-së.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 MAJ - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, zyrtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka kritikuar ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, e cila ka deklaruar se do të bashkëpunojë me Gjykatën Speciale kundër ish-krerëve UÇK-së të cilët sot gjenden në Hagë. Ai ka thënë se nëse Gërvalla ka dorëzuar dosje kundër UÇK-së në Hagë, ajo ka etiketuar emrin e saj dhe ka njollosur veprën heroike të babait të saj. "Pra, sot Donika Gërvalla duhet të përballet me ndërgjegjen e saj, pasi që UÇK-ja ndoqi rrugën e prindit të saj, Jusuf Gërvalla, rrugën e

sakrificës. Madje Donika Gërvalla e di që edhe njësitet e brigadat e UÇK-së mbajnë emrin e babës së saj, Jusuf Gërvalla. Pra nëse ka dorëzuar dosje kundër këtyre njësitëve të UÇK-së, atëherë ajo ka etiketuar emrin dhe mbiemrin e vet dhe ka njollosur veprën heroike të babait të saj", ka thënë Shala.

Ai ka kritikuar edhe presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti për sjelljen e tyre ndaj ish-krerëve të UÇK-së. "Presidentja e Kosovës, përfituesja e lirisë, znj. Vjosa Osmani, në vend të rrezitjes në detin Adriatik, që ia ka mundësuar liri e fituar me gjak nga ushtarët e UÇK-së, duhet të deklarohet si shefe e shtetit dhe e FSK-së - si trashëgimtare e UÇK-së, se a e garanton mbrojtjen në

liri të krerëve të UÇK-së në Hagë apo ka qasjen e njëjtë si të Vuçiqit?", ka thënë ai, duke shtuar se nëse Donika Gërvalla e ka bërë një gjë të tillë, duhet të kërkohej dorëheqja e saj. "Kryeministri Albin Kurti, i cili para pesë vjetëve deklaronte se 'unë nuk ju dorëzoj në Hagë në Gjykatën Speciale', të deklarohet qartë të paktën për garancinë e shtetit për '10-shin' - Rexhep Selimin. Edhe Shqipe Selimi le ta pyesë Donika Gërvallën, zëvendëskryeministren dhe ministren e Jashtme, se a ka dorëzuar dosje kundër UÇK-së? Nëse po, le ta kërkojë dorëheqjen apo shkarkimin e saj", ka vlerësuar Shala.

Më tej, ai ka thënë se Kosova tani po përballet me një pushtet arrogant dhe shpërfillës. "Duke

Donika Gërvalla: Asnjëherë nuk do të pushoj së kërkuari drejtësi për të gjitha viktimat në Kosovë



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se asnjëherë nuk do të pushojë së kërkuari drejtësi për të gjitha viktimat në Kosovë, pa marrë parasysh përkatësinë politike, gjininë, kombësinë apo funksionin e viktimave dhe autorëve të krimit. Ministrja ka pohuar se “kjo është më e pakta që mund të bëjmë jo vetëm për viktimat”. “Dje, sot, por edhe nesër. Asnjëherë nuk do të pushoj së kërkuari drejtësi për të gjitha

viktimat në Kosovë, pa marrë parasysh përkatësinë politike, gjininë, kombësinë apo funksionin e viktimave dhe autorëve të krimit. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë jo vetëm për viktimat, por edhe për gjeneratat që vijnë. Heshtja qyqare nuk e nderon asnjërin prej nesh. Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka thënë qartë fjalën e tij. Si ministre e qeverisë së zgjedhur me votën më të fuqishme qytetare i përulëm çdo vendimi të Kuvendit”, ka deklaruar ajo.

Gërvalla ka thënë se vetëm me punë mund t’ia kthejnë Kosovës faqen e bardhë. “Sot po dëgjoj si po bërtasin fort pikërisht ata që me heshtjen dhe me veprat e tyre e sollën Kosovën në këtë gjendje të turpshme. Vetëm me guxim dhe shumë punë do të mund t’ia kthejmë Kosovës faqen e bardhë, jo me heshtje dhe mashtrim. Shumë punë na presin, vërtet”, shtoi tutje ajo. Ky reagim i ministres vjen pasi në media janë kthyer disa deklarata të mëparshme të saj

për Specialen, ku kishte thënë se do të bashkëpunojë me Speciale për krimet në Kosovë. Anëtar i kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Betim Gjoshi, ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla ose shkarkimin e saj. Gjoshi në një postim në rrjetin social “Facebook” shkruan se janë dy rrugë për Gërvallën: të japë dorëheqje ose të shkarkohet. “Veç dy rrugë janë për Donika Gërvallën, urgjentisht të japë dorëheqje ose urgjentisht të

shkarkohet nga Albin Kurti”, ka shkruar Gjoshi. Sekretari i Organizatës së Veteranëve i Ushtrisë Çlirimtare (OVLUÇK), Faton Klinaku, ka thënë se Gërvalla e ka obligim të tregojë nëse ka dërguar dosje në Gjykatën Speciale kundër ish-krerëve të UÇK-së dhe, nëse po, në çfarë cilësie. “Ajo duhet të tregojë nëse ka dërguar dosje në Gjykatën Speciale dhe, nëse po, në çfarë cilësie. Nuk ka nevojë të dërgojë, se Specialja ka mjaft dosje prej prokurorisë serbe”, ka thënë Klinaku.

Holanda mbështet Kosovën në përpjekjet për luftimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar letër urim nga homologu i tij holandez, Mark Rutte. Në letrën e tij, kryeministri Rutte e ka uruar kryeministrin Kurti për pozitën e re. “Vendet tona, sikurse edhe pjesa tjetër e Evropës, janë duke u përballur me një sfidë të papërshkrueshme siç është ajo nga Covid-19”, thuhet në letër. Kryeministri Rutte shprehet i kënaqur që Bashkimi Evropian ka pasur mundësinë që t’i ndihmojë Kosovës nëpërmjet

pakos ndihmuese për Ballkanin Perëndimor dhe mekanizmit COVAX për sigurimin e vaksinave të sigurta kundër Covid-19. Ngjashëm i kishte dalë në ndihmë vitin e kaluar Kosovës Holanda edhe nëpërmjet donacionit bilateral për pajisje personale mbrojtëse për Qendrën e Klinikave Universitare të Kosovës, thuhet në njoftim. Kryeministri Rutte e ka siguruar Kurtin se Holanda e mbështet Kosovën me gjithë zemër në

përpjekjet e saj për ta luftuar korrupsionin dhe për ta fuqizuar sundimin e ligjit. “Për këtë, thotë ai, ju si kryeministër e keni marrë një mandat të fortë nga populli i Kosovës, që së bashku me zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore përbëjnë elementet kryesore të Kosovës drejt Evropës dhe integritimit evropian. Holanda është e përkushtuar ndaj rrugës së Kosovës drejt integritimit evropian”, thuhet në letër urimin e kryeministrin të Holandës, Mark Rutte.



Nxënësit e Deçanit hapin ekspozitën me vizatime për dëshmorët

DEÇAN, 4 MAJ (ER) - Në kuadër të Ditës së Dëshmorëve, kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, së bashku

me Drejtorinë e Arsimit, kanë hapur të martën ekspozitën me vizatime të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme

të kësaj komune. “Është një simbolikë që na përkujton të kaluarën tonë dhe ndihem krenar kur nxënësit i kanë në

memorien e tyre figurat kombëtare dhe historinë e popullit tonë”, ka thënë kryetari Bashkim Ramosaj.



Komuna e Vitisë dhe Caritasi zviceran rinovuan tri klasa parashkollore



VITI, 4 MAJ (ER) - Në kuadër të projektit “Shpresë”, që është bashkëpunim i Komunës së Vitisë me Caritasin zviceran në tri shkolla të Komunës së Vitisë, janë bërë renovime dhe furnizime me mjete të nevojshme për klasat

parashkollore. Basri Aliu, drejtor i Arsimit në Viti, ka treguar se bëhet fjalë për klasat parashkollore në Sh.F.M.U “Nijazi Rexhepi” Sllatinë e Epërme, paralelja e ndarë në Tërstenik, Sh.F.M.U “Dëshmorët e Vitisë”, paralelja e ndarë në

Drobesh dhe Sh.F.M.U “Hasa Alia” në Remnik të Vitisë.

Aliu ka thënë se në kuadër të bashkëpunimit të komunës me Caritasin zviceran dhe me bashkëfinancimin e tyre këto tri klasa parashkollore pos që janë rinovuar ato

janë kompletuar me mjete të konkretizimit, rafte, tavolina dhe të tjerë. Ai ka bërë me dije se në kuadër të bashkëpunimit të tyre disa edukatorë të kësaj komune veçse kanë ndjekur trajnime profesionale, kurse pjesa tjetër pritet t'i ndjekë

trajnimet së shpejti.

Aliu ka theksuar se kjo komunë është falënderuese ndaj Caritasit zviceran për këtë projekt dhe ka potencuar se kjo është në interes të edukimit dhe arsimit të gjeneratave të reja.

Daut Haradinaj paraqet kandidatin e parë për asamblist në Prishtinë

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Kandidati i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për kryetar të Prishtinës, Daut Haradinaj, ka paraqitur kandidatin e parë për asamblist në kryeqytet. Bëhet fjalë për Mehmet Kasabadiqin, të cilin Haradinaj e quan njeri i vlerave qytetare të Prishtinës së vjetër dhe arkitekt i zoti. “Sot po

fillojmë nominimet për garën e Asamblesë së Prishtinës, ku isha i nderuar me këtë nisje të mbarë, me Mehmet Kasabaqin, një njeri i vlerave qytetare të Prishtinës së vjetër dhe profesionist i zoti në fushën e arkitekturës”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



Bulliqi viziton vendin ku do të ndërtohet çerdhja e re

PODUJEVË, 4 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar vendin ku pritet që të rinovohet ndërtesa afër Shkollës

Teknike “Fan S. Noli”, që është destinuar për çerdhe. Ai ka thënë se ky ambient i plotëson jashtëzakonisht kushtet për çerdhe me hapësirat e brendshme që

ka dhe oborrin e madh. “Mezi po pres të fillojë ndërtimi i kësaj çerdhe që është më se i nevojshëm për fëmijët dhe për prindërit e kësaj zone. Për

ta parë nga afër objektin ishim bashkë me drejtorin e Arsimit, Avni Fetahu dhe dy inxhinierët nga Drejtoria e Urbanizmit”, ka thënë Bulliqi.



FSK-ja, pjesëmarrëse në mesin e 27 shteteve në ushtrimin ushtarak 'Defender Europe 21'

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 MAJ - Kosova për herë të parë do të jetë pjesëmarrëse në stërvitjen ushtarake më të madhe në rajon "Defender-Europe 21".

"Defender-Europe 21" është stërvitje vjetore e përmasave të mëdha ushtarake amerikane në Evropë dhe Afrikë, i përbashkët, shumëkombësh, i dizajnuar për ta ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ndërmjet ushtrisë amerikane, NATO-s dhe partnerëve tjerë. Me këtë rast, ushtarët e FSK-së radhiten përkrah ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s nën udhëheqjen e partnerit strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjithashtu, Kosova do të jetë në mesin e 16 vendeve pritëse, me ç'rast trupat e ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s do të zbarkojnë në Kosovë; në mesin e tyre ushtarakë të ushtrisë

amerikane, pjesëtarë të forcave nga Komanda Evropiane e ShBA-së si dhe Komanda Supreme Operacionale e NATO-s.

Komanda e Lartë (HICON) dhe Audienca Sekondare do të jenë të vendosur në Aeroportin e Gjakovës, kurse Ushtrimi Fushor do të realizohet në Zonën e Trajnimit në "Baba i Bokës" në Komunën e Gjakovës.

Validimin e kapaciteteve të këmbësorisë do ta bëjë ekipi vlerësues i KDS në bashkëpunim me ekipin ushtarak amerikan të Brigadës të Ndhmës së Forcave të Sigurisë (Security Force Assistance Brigade- SFAB).

Pjesa kryesore e ushtrimit do të realizohet nga data 17 deri 29 maj 2021.

Për detajet e pjesëmarrjes së Kosovës në këtë ngjarje, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, së bashku me komandantin e FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama, do të mbajnë konferencë për media më 6 maj në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes.



Studentët e gazetarisë paraqesin hulumtimet e tyre mbi nevojën për edukim medial në kohën e pandemisë



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Departamenti i Gazetarisë në UP, në kuadër të lëndës Edukim Medial, ka shënuar 3 Majin, Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, duke paraqitur punën e studentëve në kuadër të tryezës virtuale "Nevoja për edukim medial në kohën e pandemisë". Punimet janë realizuar gjatë këtij semestri nën mentorimit e profesorit të lëndës, prof. ass. dr. Muhamet Jahiri dhe asistentes ma. Blerta Aliu.

Studentët kanë paraqitur gjetjet e tyre lidhur me ndikimin e lajmeve të rreme gjatë pandemisë te publiku, besueshmërinë e publikut në televizion, mediat online dhe rrjetet sociale gjatë pandemisë dhe mënyrën se si është

lëkundur ai besim gjatë periudhave të ndryshme, komentet e audiencës lidhur me marrjen e vaksinës dhe besueshmërinë ndaj teorive konspirative, ndikimin e imazheve televizive rreth pandemisë tek audiencia e shumë tema të tjera. Me këtë rast, Blerta Aliu, asistente në Degën e Gazetarisë, ka theksuar se këtë vit pashmangshëm situata me pandeminë ka afektuar edhe fushën e tyre të studimit. "Të ndodhur në një situatë ku dezinformimi është kudo dhe nevoja për të krijuar aftësi për detektim dhe shmangie të lajmeve të rreme është më e madhe se kurdoherë më parë, studentët e vitit të tretë sot kanë prezantuar gjetjet e analizave të tyre që lidhen

drejtpërdrejt me këtë problematikë. Tërë këto gjetje na përforcojnë bindjen se edukimi medial është çelës për zhvillimin e mendimit kritik të audiencës lidhur me përmbajtjet mediale e posaçërisht në kohë të tilla si kjo përballje me pandeminë, ku nevoja për t'i seleksionuar burimet e informacionit dhe përmbajtjet mediale është tepër e nevojshme në mënyrë që të kemi informata të sakta", ka theksuar Aliu.

Në fund të këtij aktiviteti janë ndarë çmime për dy punimet më të mira të cilat janë mjete të teknologjisë, që do t'i ndihmojnë studentët të operojnë online gjatë mësimeve dhe janë mbështetur nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

Katër të vdekur nga Covidi dhe 75 raste pozitive për 24 orë në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 MAJ - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 1 312 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i

kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 75 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Drenas një rast (76 vjeç), Gjilan një rast (77 vjeç), Mitrovicë një rast (48 vjeç), Prishtinë një rast (79 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 105 711 raste nga 543 074 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2.191 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shënuar 546 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve deri më sot është gjithsej 96 012 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 508.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 25 raste, Fushë-Kosovë 8 raste, Istog 5 raste, Skenderaj 5 raste, Ferizaj 4 raste, Lipjan 4 raste, Malishevë 4 raste, Drenas 3 raste, Mitrovicë 3 raste, Pejë 2 raste, Podujevë 2 raste, Prizren 2 raste, Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat: Gjilan, Graçanicë, Kaçanik, Shtime, Viti dhe Vushtrri.



Mustafa: Çështja e 'Trepçës' assesi nuk do të diskutohet në Bruksel

Profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, i cili është angazhuar në grupin e ekspertëve të Kosovës për dialogun me Serbinë, ka thënë se çështja e "Trepçës" assesi nuk do të diskutohet në Bruksel. "Çështja e 'Trepçës' nuk do të duhej fare të diskutohej. Pronat që kanë ngelur atje janë çështje e gjykatave, sepse edhe Serbia edhe vendet e tjera kanë pretenduar që kanë prona në Kosovë në saje të ndërtimit të mëparshëm", ka thënë Mustafa.



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 MAJ - Profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, i cili është angazhuar në grupin e ekspertëve të Kosovës për dialogun me Serbinë, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se çështja e "Trepçës" assesi nuk do të diskutohet në Bruksel.

"Çështja e 'Trepçës' fare nuk do të duhej të diskutohej. Pronat që kanë ngelur atje janë çështje e gjykatave, sepse edhe Serbia edhe vendet e tjera kanë pretenduar që kanë prona në Kosovë në saje të ndërtimit të mëparshëm", ka thënë Mustafa.

Sa iu përket pretendimeve për prona, Mustafa ka thënë se për këtë çështje duhet drejtuar

Dhomës Speciale. "Të gjitha pronat këtu privatizohen dhe nëse dikush ka kërkesa specifike, atëherë paraqiten në Dhomën Speciale në Gjykatë Supreme, pra ose nga përfaqësuesit e firmave që pretendojnë se kanë prona ose nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, që duhet t'i kenë të drejtat tona", u shpreh Mustafa.

Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur edhe për çështjen e Ujmanit. "Çështja e Ujmanit si është nënshkruar marrëveshja në Uashington ka të bëjë me konventat ndërkombëtare. Kur një pjesë e liqenit shtrihet edhe në pjesën e shtetit tjetër atëherë në këto raste janë konventat ndërkombëtare. Unë kam këtë qëndrim", u

shpreh Mustafa.

Ai ka folur edhe për çështjen e energjisë në veri dhe për operimin e inspektorëve të ATK-së në pjesën veriore. "Çështja e rrymës në veri është çështje politike e që duhet të zgjidhet tani. Çështja e ATK-së është në kompetencë të shtetit që të hyjë atje dhe shteti duhet të organizohet për këtë", ka thënë Mustafa.

Sekretariati i Komunitetit i Energjisë vazhdon përkrahjen për sektorin e energjisë

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë pritur të martën në takim delegacionin nga Sekretariati i Komunitetit i Energjisë, i përbërë nga drejtori Janez Kopac, zëvendësrejtori Dirk Buschle dhe eksperti i energjisë elektrike, Arben Klllokoqi. Në fillim të takimit kryeministri Kurti e falënderoi Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës përgjatë viteve në zbatimin e Acquis. Më tej, Kurti e ka njoftuar delegacionin e Sekretariatit të

Komunitetit të Energjisë për prioritetet e qeverisë në kuadër të sektorit të energjisë dhe planit kombëtar për energji dhe klimë, si dhe zotimet e qeverisë në raport me mjedisin. "Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për siguri energjetike dhe energji të përbalueshme për të gjithë qytetarët dhe ekonominë e vendit, synon diversifikimin e energjisë dhe është e interesuar për investime në eficiencë të energjisë, tha kryeministri", është thënë në komunikatën e Qeverisë së Kosovës.

Sipas këtij komunikate, përfaqësuesit e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë u zotuan se do të vazhdojnë ta përkrahin sektorin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.



Pavarësisht prej pandemisë, në Kosovë rritet kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive

PRISHTINË, 4 MAJ - Lehtësimi i masave kufizuese nga pandemia Covid-19, dërgesat dhe vizitat e diasporës në Kosovë, si dhe riaktivizimi deri në një masë i aktivitetit ekonomik, u reflektuan në rritje të theksuar të kërkesës për kredi gjatë vitit 2020, veçanërisht gjatë tremujorit të katërt. Kështu thuhet në raportin "Anketa e kreditimit bankar, numër 6", të prezantuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Sipas anketës, gjatë këtij tremujori kërkesa më e madhe ishte për blerjen e shtëpive. "Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive sesa për kreditë konsumuese. Kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte një indeks pozitiv prej 0.50, ndërsa për kreditë konsumuese kishte indeks pozitiv prej 0.36. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është dukshëm më i lartë. Për më tepër vlera aktuale e kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive është pothuaj dy herë më e lartë sesa që ishin pritjet e deklaruara nga bankat", thuhet në anketë.

BQK thotë se kjo rritje u ndikua pozitivisht nga perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive. "Kjo rritje u ndikua pozitivisht nga pothuajse të gjithë faktorët e listuar në anketë, mirëpo faktori më ndikim më të lartë ishte perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive me indeks pozitiv prej 0.31, pasuar nga rritja e konfidencës së konsumatorëve dhe nevoja për financim të konsumit me indeks pozitiv prej 0.27, respektivisht 0.18", thotë BQK, raporton "Telegrafi".

Raporti thekson se në



tremujorin e parë të vitit 2021, për ekonomitë familjare, bankat komerciale në Kosovë presin rritje të kërkesës për kredi. "Në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për ekonomitë familjare, mirëpo në nivel dukshëm më të ulët se sa rritja në tremujorin aktual. Bankat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.32, përderisa kërkesa për kredi konsumuese pritet të mos ketë ndryshime të rëndësishme. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje rritjes së konfidencës së konsumatorëve dhe rritjes së kërkesës për financim të shpenzimeve të tjera", thekson raporti.

Sa i përket financimit kreditor

për bizneset, bankat në tremujorin e katërt deklaruan rritje pozitive. "Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks pozitiv prej 0.12 për ndryshimet në standardet kreditorë për NVM-të, dhe indeks pozitiv më të ulët prej 0.10 për ndërmarrjet e mëdha. Në këtë lehtësim ndikuan përgjigjet e një banke me rëndësi sistematike dhe një banke me peshë më të ulët të cilat lehtësuan standardet kreditorë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Kërkesa për kredi nga NVM-të u rrit me një indeks pozitiv prej 0.19, përderisa kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha kishte një indeks negativ marxhinal prej 0.07", thuhet në anketë.

Mbështetja e bizneseve në kreditim nga Fondi Kosovar për

Garanci Kreditorë (FKGK) thuhet se ka pasur rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditorë. "Rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditorë të aplikuara nga bankat në tremujorin e katërt 2020, rezultoi të kenë luajtur mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK, përmirësimi i perspektivës në tregjet botërore, si dhe lehtësimet rregullative për menaxhimin e efekteve të pandemisë, si restrukturimi i kredive për shkak të pandemisë Covid-19. Në linjë me ofertën e lehtësuar, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rritje të dukshme në këtë periudhë, e veçanërisht për NVM-të", tregon raporti. Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga NVM-të kryesisht u ndikua nga rritja e kërkesës për

financimin e inventarëve dhe kapitalit punues me një indeks pozitiv prej 0.19. Përderisa kërkesa për financimin e investimeve fikse kontribuoi negativisht në kërkesën për kredi me indeks negativ prej 0.28, e që mund t'i atribuohet rënies së kërkesës nga kategoria e ndërmarrjeve të mëdha.

Gjatë tremujorit të parë 2021 bankat komerciale presin që raporti i kredive joperformuese të përqësohet me një indeks prej 0.16. Bazuar në ecurinë e kreditimit gjatë vitit 2020 dhe zhvillimet me situatën pandemike, BQK-ja thotë se bankat komerciale kanë deklaruar se në përgjithësi presin rritje më të lartë të kreditimit se në vitin 2020, mirëpo në nivel më të ulët në krahasim me vitet paraprake.



Më 11 maj mbahet ankandi i letrave me vlerë

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Ministria e Financave ka bërë me dije se më 11 maj do të mbahet ankandi i shtatë i letrave me vlerë për vitin 2021. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dhjetëvjeçar në shumën prej 15 milionë

eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (10 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", është thënë në

njoftimin e Ministrisë së Financave, duke shtuar se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit ta kontaktojnë ndonjërin nga Bankat Komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës.

Kush mund të fitojë mbi Edi Ramën?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Zgjedhjet përfunduan. Tashmë dihen 140 deputetët e ardhshëm të Shqipërisë. Më parë se të ketë pasur parregullsi, ka pasur fitues e humbës. Me më shumë se 140 mijë vota plus ndaj opozitës, PD-AN, Edi Rama po vazhdon mandatin e tretë, një rast i rrallë ky në Shqipëri.

Si është pritur, sepse kështu ka ndodhur gjithnjë pas humbjeve, opozita, tani për tani, nuk i pranon zgjedhjet e verdiktin e dhënë, megjithëse të dielën në darkë ishte e bindur për fitoren. Zërat për lëvizje radikale do të shtohen në ditët e ardhshme, deri sa të shuhet. Edhe thirrjet për një "dekret të posaçëm presidencial", që do të çonte drejt anulimit të zgjedhjeve janë zëra në shkretëtirë. Ilir Meta, hëpërhe, duhet të kujdeset të çojë poturet e veta. Pastaj të shohë poturet e Edi Ramës.

Pas tetë viteve në qeverisje dhe i konsumuar nga pushteti, ku solli jo vetëm gabime të mëdha, por edhe faje, të duket e habitshme që Edi Rama ruan të njëjtën

pjesë të parlamentit.

Por, kjo ndodhi. Ajo që, nuk pranohet sot, do të pranohet nesër. Opozita do të kthehet me një këmbë në parlament, edhe pse Berisha e Mark Marku nuk duan. Nëse nuk kthehet, do të asfiksohet. Nëse kthehet me një mendim tjetër, mund të sjellë ndryshimin e saj.

Ndryshe, edhe në vitin 2025 Edi Rama do të ketë mandatin e katërt!

Kush mund ta largojë Edi Ramën nga pushteti? Të gjitha shpresat se kjo mund të ndodhë në prillin e vitit 2021 tani janë shuar. I futur në betejë që në shtatorin e vitit të shkuar, duke ngritur një korpus të tërë strukturash, ai shikonte se si kundërshtari i tij do të priste muajin shkurt për të bërë lëvizjen e radhës. Si përherë, i vonuar.

Qëndrimi i gjatë në pushtet sjell autokracinë e, më pas, oligarkinë. Autokracia e pushtetit është e dhimbshme, por përtej saj, e dëmshme. Por, edhe autokracia e liderëve të opozitës është njëlloj e dëmshme dhe e pa fryt.

Janë katër vite para deri në zgjedhjet e ardhshme. A do të ketë një figurë politike që do e përballojë autokracinë e Ramës, pushtetin e tij dhe strukturën e ngritur furishëm?

Kandidati i parë ishte Lulzim Basha.

A mundet ai ta bëjë këtë, qoftë

edhe pas katër viteve?

E vështirë, në mos e pamundur. Në zgjedhjet e 25 prillit Basha kishte sigurinë e verbër të shigjetës, që nuk shikon asgjë tjetër veç Nishanit.

Në politikë nuk ka gjë më të gabuar se siguria e verbër. Basha ecte para, por në mënyrë fatale. Ndryshe nga të tjerët, ai dinte gjithçka dhe mohonte gjithçka. E dinte humbjen, por e mohonte dorëheqjen. Ai e ktheu PD-në në një mishmash politik, ky është gabimi i atyre mendjeve që zëvendësojnë arsyen dhe logjikën me përkohshmërinë dhe cektësinë.

Asnjëri prej atyre që e rrethon nuk është më i aftë se sa ai; meskiniteti rrethues bëri që dishepujt e tij të ishin "revole në xhepa", por jo mendje. E ktheu PD-në, edhe më tej, në një sallë ku është e pranishme gjithçka: padija, budallallëku, pritshmëria, zemërimi, mëria, përbuzja ndaj vlerës dhe pritja. Më tej, gjumi.

Dalja e tij nga parlamenti, duke lënë sheshin e lirë për kundërshtarin ishte budallallëku më i madh që mund të bëjë një drejtues partiak. Ende, as sot, askush nuk e di pse dolën, si lindi kjo ide një mbrëmje dhe u bë fakt në mëngjes. Basha, edhe pse më i afirmuari, nuk është njeriu që mund të prijë gjatë, pasi gjithçka e ka fituar lehtë, nga miqësia me bijën kryeministore dhe pazaret

e radhës.

Në PD ka burra të denjë për Shqipërinë, por më shumë burra të denjë për burgun. Të denjë për Shqipërinë, me përjashtime të veçanta, u braktisën, të denjë për burgun u afruan.

Basha u emërua kryetar, por nuk u bë lider. Ai mund të mbetet kryetar, por karrigen e liderit e ka dikush tjetër. Nuk mund të jesh gjithkush, kur nuk të do askush. Ai hyrë në zgjedhje për të qenë Njëshi i vetëm, por ngeli vetëm aq. Shtesa e votuesve në zgjedhjet e fundit nuk është gjë tjetër veçse rikthimi i plangprishësve të katër viteve më parë. Të mburresh se t'u kthyen njerëzit në shtëpi, do të thotë se deri asaj dite ke pasur portën e mbyllur.

Basha është njeri që mendon se është i pagabueshëm, kur gabimet ia kanë zënë frymën forcës së tij politike. Jo braktisja, por të qenit i pranishëm është vlerë. Ikja nga parlamenti e bëri atë burracak, kur mendoi se po trimërohet. Përbetimi i tij ishte i shurdhër dhe shikimi i tij ishte i mangët.

Basha nuk do e mundë asnjëherë Edi Ramën. Nuk ka stofin e njeriut që fiton, por të atij që ankohet. Nuk është virtyti, por shpirti i munguar. Viti 2017 tregoi se është lehtësisht i manovrueshëm dhe i thyeshëm. Lakmia e tij është dobësia e tij. Viti 2021 tregoi se, me gjithë

zërin e prerë dhe këshilltarët izraelitë, ai nuk bëhej dot Jezusi i demokratëve. Izraelitët "e vranë" që në çastin kur e mësuan të hipte mbi makinë. Ai është dëndy, jo prijës. Hipja në makinë nuk të bën prijës e as lider. Idetë të bëjnë. Forca të bën. Vizioni të bën. Nuk mund të jesh i madhërishtë kur rrezohesh dhe ai është rrezuar katër herë.

Berisha është i vetmi që mund të krahasohet me Ramën. Ai mund ta rrezojë Edi Ramën, ashtu si Edi Rama e rrezoi atë.

Por Berisha ka kundër vetes dy gjëra: moshën dhe konsumimin e aktit të tij politik. Ai është i furishëm, por jo i besuar. Ai të indinjon kur mohon gjithçka dhe nuk besohet kur pohon gjithçka. Por ai ka në anën tjetër dy gjëra që i mungojnë Bashës: është i furishëm dhe e njeh lojën e politikës me mirë se bisturinë.

Për Berishën nuk ka rrugë të mesme. Ose të gjitha, ose asgjë. Ai nuk do e kishte bërë kompromisin e vitit 2017 dhe vështirë se do e besonte se hipja mbi makinë dhe përbetimet e dhuratave të shtojnë votat.

Berisha i njeh njerëzit, ai e beson se një popull praktik e di se nga kumbullat e tharta, të mpihen dhëmbët. Ai ka një mënyrë të foluri të prerë, plot zjarr dhe pasion, theksin të vendosur dhe e gjithë fytyra e tij ka pamje të indinjuar. Edhe kur mashtron, edhe kur thotë të vërtetën, nuk



skuqet.

Është i vetmi që e di se nuk mund të fitohet me Edi Ramën përmes votave, por me dhunë. E predikon dhunën tash 30 vite dhe kjo e ka bërë të pabesueshëm për shumicën, por idhull për pakicën.

Ai ishte dikur shërbëtor i gjinisë njerëzore, për t'u bërë më pas demoni i saj.

Ai e trajton partinë si fëmijën e tij, ndërsa Luli si njerë! Berisha i sheh asaj pushtetin, Basha i sheh pasurinë! Berisha është tragjik në qëndrimin e tij, Basha anon nga komikja.

Berisha do të kishte shansin, nëse do të ishte 30 vite më i ri. Ai ende e di se në PD nuk ka asnjë tjetër më të mirë, më besnik dhe shpërblesë se sa Basha. Përmes tij, tani për tani, mbron veten, fëmijët dhe të shtuarit e familjes. Nëse mendon se Basha nuk e bën më këtë, ai do e largojë dhe do të zgjedhë një tjetër, që t'i ngjajë, ta rritë vetë katër vite dhe të jetë alter egoja e tij.

Basha e sheh katastrofën në lindje, kur ajo është në perëndim. Basha, edhe në janarin e këtij viti, nuk e dinte se kush do të ishin drejtuesit politikë, ndërsa Berisha do i kishte caktuar një vit para. Edi Rama gëzohet me pleqërinë e Berishës dhe me parritjen e Bashës.

Shkakun e humbjes shpesh herë njerëzit e gjejnë në moshapjen e opozitës. Nuk është kjo. Humbja është në filozofinë e saj, në perceptimin e së keqes si mundësi dhe afishimin e saj si rrugë qeverisjeje.

Një opozitë që nuk shkëputet dot nga ngjarje tragjike që ka mbjell në qeverisjen e saj, si 21 janari, Gërdeci etj nuk mund të rivijë në pushtet, pasi është kërrusur nën peshën e fajit. Aq më tepër, kur nuk shkëputet dot nga filozofia e tërheqjes pranë vetes të strukturave të dhunës dhe moskundërshtimit të së keqes, sa herë që ajo shfaqet.

Opozita mund të ketë Lulzim Bashën drejtues, ose ta largojë atë, por kjo nuk e ndryshon dhe nuk e afrohet me fitoren. Ai, në fakt, me gjithë mëkatet, sundon mbi ato që ka pranë dhe, megjithëse do të ndjejë shpejt peshën e sulmeve kundër tij, mund t'i përballojë. Askujt nuk i vjen largimi nga mediokriteti.

Atëherë, kush do e mundë atë? Meta tashmë kërkon shumë kohë që të merret seriozisht. Pasi përfundoi pajtimin në familje, tani do t'i duhet shumë kohë të gjejë rrugën për t'u menduar se ka ndryshuar.

Sa të bëhet ai i besueshëm, Rama ka marrë mandatin e katërt!

Meta iku nga trualli i rritjes së tij, nga socialistët, për të ngrënë në çanakun e të djathtëve, të cilët humbën edhe prej tij.

Askush nuk i ka sjellë më shumë dëm PD-së në këto zgjedhje, se sa ngërdheshjet politike dhe britmat çjerrëse të Metës. I rrethuar nga dallkautë, të cilët mendojnë se të flasin brutalisht

janë të fortë, ai është në pikën më të ulët të popullaritetit të tij.

Ka shumë që mendojnë se lista e përbashkët e opozitës, PD-LSI do u sillte fitoren. Do të kishte ndodhur e kundërta. LSI ishte në këto zgjedhje "delja e zezë" dhe humbja do të kishte qenë më e madhe. Ata që votuan PD-në, duke u kthyer në traditën e tyre, do të kishin munguar, nëse lista do të kishte qenë e përbashkët. Është e vështirë t'ia mbushësh mendjen një demokraci se votimi i Kryemadhit është vlerë.

Po sjell shembullin e mëposhtëm: një institucion tejet i rëndësishëm ndërkombëtar, i cili monitoroi me kujdes fushatën zgjedhore, në fillimin e nëntorit vuri re rritje të besimit ndaj PD-së në një qark të njohur si bastion i së majtës, në Vlorë. Përqindja luhatej nga 32 deri në 34 për qind dhe, në tri javët e mbetura do t'i duheshin edhe rreth 2200 vota plus që të arrihej mandati i pestë. Ndërhyrja e Ilir Metës, takimet e tij me drejtuesin politik të opozitës në Vlorë, shpallja e tyre hapur, nuk e di nëse kjo ndodhte me dëshirë të dyanshme, loja e fjalëve etj, bëri që përqindja të ulej, dhe balanca të kthehej aty ku kishte qenë. Po të kishte ndodhur kjo në gjithë vendin, abstenimi do të kishte qenë i ndjeshëm.

Meta, me gjithë përбетimet, ndihmën e Petrit Vasilit dhe deklaratat e forta, nuk e mund Edi Ramën.

Atëherë kush?

E para gjë që mund të sjellë ndryshimin e duhur dhe të bëjë që edhe Edi Rama të jetë më i përgjegjshëm është një lëvizje e re politike, brenda sistemit. Është e domosdoshme të ndodhë, por jo në çastin e fundit dhe me frymëzim qeveritar.

Shenjat e para janë dhënë. Shumë deputetë të rinj, thuaj në të gjitha qarqet, u votëbesuan me më shumë vota se sa brezi i vjetër. Njerëzit janë lodhur prej tyre.

Kjo është një shpresë.

Një mundësi.

A mund të ketë një lëvizje të furishme politike, e cila, edhe pse duket tani për tani e pafuqishme, mund të jetë opozita e vërtetë, ose, më saktë, krahu i domosdoshëm i opozitës. Por, jo të kësaj që kemi, kështu si e kemi, e cila është në fakt opozita e vilave dhe resorteve luksoze.

Një opozitë e dhunshme nuk sjell mendim e as vizion të ri. Nuk mund të jesh qeverisës duke shkallmuar dyer qeverish, si bëri dhjetë herë rresht Basha e dështoi dhjetë herë.

Një komb prosperon përmes mendjes dhe qytetërimit. Përmes të tërës dhe jo pjesës!

Nëse do të luftojmë për Krahinë, do të harrojmë Atdheun!

Mendimi e çon shpirtin tek idetë e përgjithshme; mbyllja dhe aneksimi i ideve pjellin vizione shtatanike.

Konfiskim po, por edhe dekonfiskim

Prof. dr. Abdullah
KARJAGDIU

S'ka pikë dyshimi se Ligji për konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë të paligjshme dhe kriminale është tejet i dobishëm dhe i domosdoshëm. Për krijimin e pasurisë në Kosovë në mënyrë të jashtëligjshme, duke uzurpuar pasuri publike dhe private, por edhe duke i keqpërdorur të dhënat kadastrale, procedurat ligjore, prokurimet dhe vetë ligjet dhe duke e shndërruar këtë aktivitet pasurimi në krim të organizuar, faktajnë edhe raportet vjetore të vlerësimit raportues për Kosovën, ku llojet dhe natyrat e kriminimit dhe korrupsionit janë nga më të sofistikuarat dhe më të tmerrshmet.

Por, që ky Ligj të mos shndërrohet në një ligj me përmbajtje dhe metodologji të ngjashme me atë të ish-sistemit socialist dhe komunist në Kosovën e ish-Jugosllavisë, përkatësisht në Ligjin për konfiskimin e pasurisë së kundërshtarëve politikë, atëherë krahas Ligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, Qeveria Kurti do të duhej ta inicioje edhe hartimin dhe miratimin e Ligjit për dekonfiskimin apo për kthimin (restituimin) dhe kompensimin e pronave të konfiskuara padrejtësisht nga patriotët shqiptarë në Kosovë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, që është përdorur nga ish-regjimi komunist serbo-jugosllav në Kosovë si mjet për luftimin e patriotëve shqiptarë, të cilët luftuan, derdhën gjak dhe u vranë për bashkimin e trojeve shqiptare.

Dihet se, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, e sidomos gjatë periudhës, periudhës 1945-1948, autoritetet serbe hegjemoniste nëpërmjet politikave shtetërore, me qëllim të kolonizimit të Kosovës, dhe përmes akteve përcjellëse juridike i kanë konfiskuar pronat, me ç'rast kryesisht i kanë diskriminuar dhe dëmtuar rëndë shqiptarët autoktonë, që kanë luftuar, rezistuar dhe rënë dëshmorë për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Konfiskimet e pasurive të shqiptarëve në Kosovë autoritetet serbe i kanë aplikuar me qëllim të përndjekjeve të planifikuara të



familjeve të aktivistëve politikë, luftëtarëve dhe dëshmorëve të kombit të rënë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Këto prona në disa raste madje janë marrë edhe pa kurrfarë gjyqi apo janë grabitur, ndërsa në mjaft raste edhe përmes proceseve gjyqësore të kurdisura, ashtu që patriotë dhe luftëtarë dhe dëshmorë të spikatur, apriori, janë stigmatizuar arbitrarisht si "armiq të shtetit jugosllav" dhe si të tillë edhe familjet e tyre janë njollosur dhe janë privuar nga e drejta për punë, shkollim, pronë dhe janë persekutuar penalisht dhe krahas kësaj atyre u është konfiskuar edhe pasuria ose në shumë raste edhe janë dëbuar në Turqi.

Mirëpo, ndonëse kanë kaluar 21 vjet nga çlirimi dhe 13 vjet nga pavarësia e Kosovës dhe megjithëse të gjitha vendet ish-komuniste dhe vendet e Ballkanit jo vetëm që e kanë miratuar këtë ligj, por edhe e kanë zbatuar tashmë në tërësi, në Kosovë nuk është bërë pothuajse asnjë përpjekje që të hartohet dhe miratohet një ligj i tillë.

Përrashtim përbën Qeveria e Isa Mustafës, kur ish-ministri i Drejtësisë, prof. dr. Hajredin Kuçi, në tryezën e organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me USAID-in, me rastin e fillimit të hartimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, të mbajtur më 22 qershor 2016, pati deklaruar se: "Konfiskimet e pronave në kohën e komunizmit dhe më herët do të kompensohen me ligj. Mbrojtja e jetës, lirisë dhe pronës janë detyra të institucioneve shtetërore". Për më tepër, ministri Kuçi me atë rast ishte përqëndruar në nevojën e institucioneve që të bëjnë analizimin e politikave konkrete për kompensim të pronave të konfiskuara nga regjimi komunist jugosllav. Sipas tij: "Hartimi i një ligji për

kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë komunizmit është i nevojshëm, duke u bazuar në modelet e vendeve tjera që kanë adresuar këtë çështje".

Por, për fat të keq, që nga ajo kohë, për shkak të prioritetëve të tjera të qeverive të Kosovës dhe jostabilitetit politik në Kosovë gjatë viteve të fundit, lidhur me këtë çështje nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë dhe nuk është bërë as përpjekje minimale për hartimin e këtij ligji. Ndaj, më duhet të them me keqardhje shumë të madhe se, me evitimin e zgjidhjes së këtij problemi deshën apo s'deshën politikanet tanë, në mënyrë paradoksale po identifikohen me qëndrimet e mëparshme të pushteteve serbo-sllave antishqiptare dhe antidemokratike, sepse kështu po shkelen parimet e së drejtës se pronës, lirisë, barazisë dhe demokracisë. Ç'është akoma më e rëndësishme, pa miratimin dhe zbatimin e këtij ligji Kosova jo vetëm që nuk mund ta vazhdojë integrimin e mëtejshëm në BE, por madje, sipas disa informatave jozyrtare, as nuk do të mund ta marrë liberalizimin e vizave.

Së këndejmi, është koha e fundit që Qeveria e Republikës së Kosovës, krahas Ligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, ta hartojë sa më parë dhe ta dërgojë për miratim në Kuvend edhe Ligjin për dekonfiskim apo për kthim (restituim) dhe kompensim të pronave të konfiskuara padrejtësisht nga patriotët shqiptarë në Kosovë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore (1945-1948), ngaqë ky Ligj është po aq i domosdoshëm, demokratik dhe patriotik sa edhe Ligji për konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë joligjore dhe kriminale. Konfiskim po, por edhe dekonfiskim!

Trajneri i Torinos: Jam me fat që kam lojtarë të tillë si Vojvoda

TORINO, 4 MAJ - Trajneri i Torinos, Davide Nicola, e ka lartësuar Mërgim Vojvodën për golin me të cilin mbrojtësi kosovar e frytëzoi skuadrën e tij drejt një fitoreje vendimtare kundër Parmës në betejën e mbijetesës në Serinë A. Përfaqësuesi i Kosovës, Vojvoda, e shënoi golin

e parë në fanellën e Torinos të hënën në Stadiumin Olimpik, duke ia siguruar pothuajse edhe matematikisht mbijetesën skuadrës së tij dhe duke e dërguar Parmën në Serinë B. Vojvoda shënoi në portën boshe pasi erdhi me vrap nga plani i dytë, duke e shfrytëzuar

depërtimin dhe pasimin fantastik nga Christian Ansaldi në minutën e 63-të. Nicola, i cili e parapëlqeu kosovarin para Wilfried Singos në krahun e djathtë, u shpreh shumë i lumtur që Vojvoda e shfrytëzoi mundësinë që iu ofrua. Duke folur pas ndeshjes, Nicola ka

thënë: "Mes pezullimeve dhe koronavirusit, unë jam gjithmonë në gjendje të zgjedh se kush mund të më ofrojë më së shumti mua". "Singo po luan mirë dhe do të bëhet top lojtar në rolin e tij, por unë jam me fat që kam lojtarë të cilët dinë sesi t'i shfrytëzojnë mundësitë. Jam i



lumtur për Vojvodën, edhe nëse ai ka mundur ta shfrytëzonte më mirë mundësinë e dytë që e kishte", ka shtuar Nicola.

Kuka: Koha të udhëheqin njerëzit e duhur në sport

PRISHTINË, 4 MAJ - Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, ka thënë se Kosova duhet të bëhet me Këshillin Kombëtar të Sportit. Trajneri Kuka ka thënë se në shumë federata po udhëheqin njerëz jo të duhur pa ndonjë kontribut. Sipas tij, ka ardhur koha të udhëheqin meritoret. Kuka theksoi se rezultatet e garave ndërkombëtare po manipulohen nga shumë federata, duke pretenduar për thyerje të rekordit. Ai bëri thirrje që të mos lajthitet opinioni publik. "Ka ardhur koha që Kosova ta ketë Këshillin Kombëtar të Sportit. Jo të bëhet me vota, po me kriter. Sporti s'është politikë e as klub sportiv të bëhet tifo! Këshilli Kombëtar i Sportit domosdoshmëri! Me njerëz me kredibilitet të lartë personal, me bagazh të sportistit e jo turistit. Organizatat sportive janë mbushur me njerëz që askush s'i njeh për kontribut në sport dhe kjo është në trend. A ka krizë në sportin e shtetit tonë, patjetër që po. A ka analizë të performancës



të federatave shumë pak ose aspak", ka thënë Kuka. "Disa garues shkojnë në Kampionate Evropiane e Botërore e raportohet se janë thyer rekordet e Kosovës. Pse ky fenomen, atje shkohet të garohet me shtete të tjera e jo e kundërta. Mos të lajthitet opinioni! Nëse shikohet numri i federatave e shohim një numër të madh të tyre, por sa prej tyre janë serioze në prezantim dinjitoz ndërkombëtar? Shumë

numër i vogël! Sa sporte kanë fituar medalje elitare prej përfundimit të luftës e këndej? Të analizohet pse?", ka shtuar ai. Driton Kuka theksoi se fokusi kryesor është te paraja dhe jo te suksesi. "Kur flitet për buxhet krejt gjejnë arsytetime e kërkojnë modele për të marrë ndonjë euro më shumë, por sa nga mjetet nëpër federata investohen seriozisht në sportistë e trajnerë?", ka deklaruar Kuka.

Lakersat u rikthehen fitoreve

LOS ANXHELOS, 4 MAJ - Los Angeles Lakers la pas ecurinë negative në NBA prej tri humbesh radhazi. Kampionët në fuqi u rikthyen te suksesi në sfidën shtëpiake ndaj Denver Nuggetsit duke ndaluar hovin e skuadrës nga Colardo që vinte në këtë sfidë pas pesë fitoresh radhazi. Edhe pse pa LeBron Jamesin dhe gjermanin Denis Schroder që vazhdojnë të jenë të lënduar, lakersat arritën të ngrenë kokë falur yllit tjetër të ekipit, Anthony Davis, i cili koleksionoi në total 25 pikë dhe 7 rebounde. Te Denveri spikati i përhershmi Nikola Jokiq, por as 32 pikëve, 9 rikuperimet poshtë tabelës dhe 5 asistimet e tij nuk ishin të mjaftueshme për ta evituar humbjen e 22-të sezonale me shifrat finale 93-89. Ndërkohë La Lakersi me këtë sukses ruajti vendin e 5-të në Konferencën e



Perëndimit që tashmë kërcënohet nga Dallas Mavericksi. Vazhdon rivaliteti i ashpër mes Utah Jazzit dhe Phoenix Sunsit për vendin e parë në Perëndim në sezonin e rregullt. Utah mori sërish kryesimin falë suksesit 110-99 ndaj San Antonio Spursit. Kroati Bojan Bogdanoviq dhe francezi Rudy Gobert regjistruan së bashku 49 pikë në total duke

udhëhequr skuadrën nga Salt Lake City drejt fitores së radhës. Philadelphia 76-ers vijoi ecurinë e përkryer duke marrë fitoren e pestë radhazi në transfertën e Illinois ndaj Chicago Bullsit me shifrat 106-94. Për kryesuesit e Konferencës së Lindjes të cilët po vijojnë të rivalizojnë fort me Brooklyn Netsin spikatën Harrisin dhe Curry, respektivisht me 21 dhe 20 pikë. Atlanta Hawksi u ngjiti në vendin e 5-të në Lindje falë suksesit 123-114 ndaj Portland Trail Blazersit, ndeshje në të cilën shkëlqeu Damian Lillard i miqve, por 33 pikët e tij nuk mjaftuan, ndërkohë që te skuadra nga Georgia shkëlqyen italiani Danilo Gallinari me 28 pikë dhe serbi Bogdan Bogdanoviq me 25 pikë. Portlandi me këtë disfatë prishi ecurinë prej katër fitoresh rresht.

SHKURT

Roma ndan rrugët me trajnerin Fonseca, zyrtarizon Mourinon

Paulo Fonseca nuk do të jetë trajner i Romës për sezonin e ardhshëm. Palët nuk kanë gjetur gjuhën e përbashkët dhe klubi italian ka dalë me një komunikatë zyrtare. "Në emër të të gjithëve te Roma, duam ta falënderojmë Paolo Fonsecan për punën e palodhur që ka bërë në krye të ekipit këto dy vjet. Ai e drejtoi ekipin duke kaluar disa sfida, si pandemia e Covid-19 dhe ndryshimi i pronësisë së klubit, dhe e bëri me karakter dhe drejtësi. Ne i urojmë më të mirat në të ardhmen dhe jemi të sigurt se do të jetë një vlerë e shtuar kudo që të shkojë", thuhet në njoftimin e klubit italian. Skuadra nga kryeqyteti italian nuk ka humbur kohë dhe të martën e ka zyrtarizuar Jose Mourinon trajner të ri. Portugezi do ta marrë drejtimin e Romës pas përfundimit të këtij edicioni. Kontrata e strategut portugez me klubin italian është deri në vitin 2024.

Finalja e Ligës së Evropës do të luhet me tifozë

Finalja e Ligës së Evropës do të luhet me tifozë pasi UEFA ka dhënë dritën jeshile. Ndeshja që do të luhet në "Energa Stadium" të Gdanskut në Poloninë Veriore do të ketë 9 500 tifozë. Në fakt, kjo është vetëm 25 % e stadiumit pasi në total kapaciteti është 43 615. Ende nuk është zyrtarizuar kush do të luajë në atë finale, por më i favorizuar është Manchester Unitedi që ka mposhtur në ndeshjen e parë 6-2 Romën, kurse te sfida tjetër Villareali ka avantazhin 2-1 ndaj Arsenalit, por duhet ta ruajë atë edhe në Londër.

Sportingu synon rikthimin e Ronaldos

Cristiano Ronaldo dhe Juventusit së bashku deri në vitin 2022, por thashethemet rreth lamtumirës së tij me fanellën bardhezi po bëhen gjithnjë e më këmbëngulëse. Sipas gazetës sportive luzitane "Record", ylli portugez do të tundohej nga një kthim në atdheun e tij. Ai do të donte ta përfundonte karrierën e tij atje dhe të luante mbi moshën 40 vjeç dhe do ta bënte këtë vetëm me fanellën e Sporting Lisbonës. Një "bombë" e vërtetë merkatoje që është e destinuar të alarmojë të gjithë në Torino, sidomos tifozët dhe drejtuesit e "Zonjës së Vjetër".

Martinezi largohet nga Bayerni

Pas nëntë viteve se bashku, FC Bayern Munich ka konfirmuar që Javi Martinez do largohet në fund të sezonit. Klubi dhe lojtari kanë arritur marrëveshje që të mos e vazhdojnë kontratën pas 30 qershorit. Këtë e ka konfirmuar Bayerni përmes një komunikate zyrtare: "FC Bayern dhe Javi Martinez i thonë mirë u pafshim pas nëntë viteve të suksesshme se bashku dhe faleminderit nga zemra. Klubi dhe lojtari kanë arritur marrëveshje të mos e vazhdojnë kontratën pas 30 qershorit", shkruhet në komunikatë. 32-vjeçari ka fituar Superkupën e UEFA-së, dy herë Kupën e Botës për klube, Kupën e Gjermanisë pesë herë dhe Superkupën e Gjermanisë katër herë, nëntë herë Bundesliga dhe dy herë Ligën e Kampionëve.

Lukaku: Benzema është sulmuesi më i mirë në botë

I ftuar te "La Tribune", program belg i RTFB, Romelu Lukaku ka folur për ndjesitë e tij si kampion i freskët i Italisë, duke bërë një urim edhe për shokët e kombëtares. "Shpresoj me të vërtetë që lojtarët e tjerë të Djajve të

Kuq të fitojnë tituj: Courtois, Eden e Thorgan Hazard, Witsel, De Bruyne", ka thënë Lukaku. "Të fitosh një titull me klubin të ndihmon të fitosh përvojë dhe të kuptosh si duhet të përgatitesh për një ndeshje. Të jep

një mentalitet vrasës, që më kishte munguar pak në karrierë", ka vazhduar sulmuesi. "Jam dorëzuar shumë herë, më pas i kam thënë vetes: 'Mjaft, ka ardhur momenti që të ndryshoj'. Jam i lumtur sepse jemi

kampionë, por tani jam i përqendruar tek Evropiani", ka deklaruar Lukaku. I pyetur se kush është sulmuesi më i mirë në botë, Lukaku është përgjigjur: "Padyshim Karim Benzema".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e Drejtorit në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit

Sipas Ligjit nr. 05/L - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, me Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, udhëheq drejtori. Drejtori zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Kandidati për drejtor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku tre (3) vjet përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për veprë penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **19.05.2021, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor direktora Regulatornog autoriteta vodnih usluga

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju vodnih usluga, Regulatorni autoritet vodnih usluga vodi direktor. Direktor se bira na mandat od pet (5) godina, sa mogućnošću ponovnog izbora na još jedan mandat.

Kandidat za direktora Regulatornog autoriteta za vodne usluge, treba da ispunjava sledeće uslove:

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje univerzitetsku diplomu četvorogodišnjih (4) studija ili završen master;
- da nije bio osuđen za krivično delo, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u struci.

Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 19.05.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregulator për Shërbimet e Ujit

Sipas Ligjit nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Komisioni Shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim. Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues zgjidhet për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Kandidati për kryesues të Komisionit Shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku tre (3) vjet përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **19.05.2021, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo objavljuje:

KONKURS

Za izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Regulatornom autoritetu za usluge voda

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju usluga voda, Komisija za razmatranje se sastoji od predsedavajućeg, izabranog od strane Skupštine Republike Kosova, jednog člana imenovanog od strane Autoriteta i jednog člana imenovanog od strane pružioća usluga koji je podneo zahtev za razmatranje.

Mandat predsedavajućeg Komisije za razmatranje:

Predsedavajući Komisije za razmatranje bira se na mandat od tri (3) godine, uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.

Kandidat za predsedavajućeg Komisije za razmatranje treba da ispunjava sledeće uslove:

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje univerzitetsku diplomu četvorogodišnjih (4) studija ili završen master;
- da nije bio osuđen za krivično delo, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u struci.

Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 19.05.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).


Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE

Mehmet Kraja



HËNA PREJ LETRE

(Drama, trilogji)

